

**Ligji Nr. 04/L-005
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2004/18 PËR TREGTINË E BRENDSHME**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2004/18 PËR TREGTINË E BRENDSHME

Neni 1

1. Neni 2 i ligjit bazik, përkufizimi **“Konsumator”** riformulohet si vijon:

“Konsumator” - nënkupton çdo person fizik që blen dhe përdor mallra ose shërbime për plotësimin e nevojave të veta dhe jo për qëllime tregtare.

2. Neni 2 i ligjit bazik, përkufizimi **“Ministri”** riformulohet si vijon:

“Ministri” - nënkupton Ministrinë e tregtisë dhe industrisë.

3. Neni 2 i ligjit bazik, përkufizimi **“Shitës apo furnizues”**, fshihet në tërësi dhe riformulohen dy përkufizime të reja me tekstin si vijon:

“Shitës” - nënkupton personin fizik dhe/apo juridik që shet mallra apo i kryen shërbim konsumatorit.

“Furnizues” - nënkupton personin fizik dhe/apo juridik që ofron mallra tek shitësi në përputhje me veprimtarinë tregtare apo profesionin e tij.

4. Neni 2 i ligjit bazik, pas përkufizimit **“Influencia e padrejtë”**, shtohet një përkufizim i ri si vijon:

“Komisioni” - nënkupton pjesën e fitimit që e merr agjenti si rezultat i realizimit të një transaksioni.

Neni 2

Neni 16 i ligjit bazik, fshihet nga teksti i ligjit dhe në tërë tekstin e ligji fshihen fjalët **“leja e punës”**.

Neni 3

Neni 20 i ligjit bazik paragrafi 20.2 pika c. fjala **“principali”** zëvendësohet me fjalën **„urdhërdhënësi“**, ndërsa pjesa tjetër e tekstit mbetet e njëjtë.

Neni 4

Neni 35 dhe neni 37 i ligjit bazik fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 5

Neni 38 i ligjit bazik, paragrafët 38.3, 38.4, 38.5, 38.6, 38.7 dhe 38.8 fshihen nga teksti i ligjit.

Neni 6

Neni 39 i ligjit bazik fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 7

Neni 45 i ligjit bazik, pikat h. dhe i. fshihen nga teksti i ligjit.

Neni 8

1. Neni 55 i ligjit bazik, paragrafi 55.1 riformulohet si vijon:

55.1. Inspektori me vendim ndalon përkohësisht veprimtarinë e tregtarit nëse gjatë inspektimit konstaton se:

2. Pikat e paragrafit 55.1 të ligjit mbesin mbesin të pa ndryshuara.

3. Neni 55 i ligjit bazik, paragrafi 55.2. fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 9

Neni 57 i ligjit bazik, paragrafi 57.1. riformulohet si vijon:

57.1. Nëse inspektori i autorizuar gjatë inspektimit konstaton që personi nuk i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 38 të këtij ligji ose tregtari nuk respekton orarin e përcaktuar të punës të paraparë në nenin 40 të këtij ligji, me vendim, i ndalon tregtarit afarizmin në kundërshtim me orarin e përcaktuar të punës.

Neni 10

Neni 58 i ligjit bazik, riformulohet si vijon:

58.1. Ankesa kundër vendimit të inspektorit në bazë të neneve 53, 54, 55, 56, dhe 57 të këtij ligji i drejtohet Kryeinspektorit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në afat prej tetë (8) ditësh.

58.2. Kryeinspektori vendos në lidhje me ankesën e ushtruar në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e parashtrimit të ankesës.

58.3. Kundër vendimit të Kryeinspektorit mund të parashtrohet padi në gjykatën kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditësh.

Neni 11

1. Neni 60 i ligjit bazik, paragrafi 60.1. riformulohet si vijon:

60.1. Me gjobe në shume prej një mijë (1000) deri tremijë (3000) Euro ndëshkohet personi juridik, ndërsa në shume prej dyqind (200) deri pesëqind (500) Euro personi fizik.

2. Neni 60 i ligjit bazik, paragrafi 60.1. pikat e këtij paragrafi mbesin të pandryshuara, përpos pikës h. e cila fshihet nga teksti i ligjit.

3. Neni 60 i ligjit bazik, paragrafi 60.2. pas fjalëve “**personi përgjegjës**” shtohen fjalët “**i personit juridik**”.

Neni 12

Neni 61 i ligjit bazik, riformulohet si vijon:

61.1. Me gjobë në shumë prej dymijë (2.000) deri gjashtëmijë (6.000) Euro ndëshkohet personi juridik i cili shet mallëra në ambient të hapur, dhe nuk është i regjistruar, respektivisht nuk ka leje për ushtrimin e veprimtarisë së tregtisë ose shitjen e mallërave të cilat nuk mund të shiten në ambient të hapur.

61.2. Me gjobë në shumë prej dyqind (200) deri gjashtëqind (600) Euro ndëshkohet personi përgjegjës i personit juridik sipas paragrafit 1. të këtij neni.

61.3. Me gjobë në shumë prej pesëqind (500) deri njëmijë (1.000) Euro ndëshkohet personi fizik i cili shet mallra në ambient të hapur dhe nuk është i regjistruar, respektivisht nuk ka leje për ushtrimin e veprimtarisë së tregtisë ose shitjen e mallrave të cilat nuk mund të shiten në ambient të hapur.

61.4. Me gjobe në shume prej katërmijë (4.000) deri tetëmijë (8.000) Euro ndëshkohet personi juridik për kundërvajtje për shkak të shitjes në ambient të hapur, pas shqiptimit të gjobës së parë sipas paragrafit 1. të këtij neni.

61.5. Me gjobe në shumë prej pesëqind (500) deri njëmijepesëqind (1.500) Euro ndëshkohet personi përgjegjës i personit juridik sipas paragrafit 4. të këtij neni.

61.6. Me gjobe në shumë prej tremijë (3.000) deri nëntëmijë (9.000) Euro ndëshkohet personi fizik i cili shet në ambient të hapur edhe pas paralajmërimit të inspektorit.

61.7. Me gjobë në shumë prej njëmijë (1.000) deri tremijë (3.000) Euro ndëshkohet personi juridik nëse gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij tregtar nuk i përmbahet orarit të punës bazuar në nenin 40 të këtij ligji.

61.8. Me gjobë në shumë prej dyqind (200) deri gjashtëqind (600) Euro ndëshkohet personi përgjegjës i personit juridik sipas paragrafit 7. të këtij neni.

61.9. Me gjobë në shumë prej treqind (300) deri njëmijë (1.000) Euro ndëshkohet personi fizik nëse gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij tregtar nuk i përmbahet orarit të punës bazuar në nenin 40 të këtij ligji.

Neni 13 Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikë së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/ L-005
23 qershor 2011**

**Shpallur me dekretin Nr.DL-004-2011, datë 08.07.2011 nga Presidentja e Republikës së Kosovës
Atifete Jahjaga.**